



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

BASHKIA PATOS
KRYETARI

Nr. 213 Prot.

Patos, më 19 / 01 / 2026



MIRATOHET
KRYETARI
Fation Duro

PROJEKTVENDIM

Nr. 02, datë 19 / 01 / 2026

PËR MIRATIMIN E PËRDORIMIT TË GRANTIT ME BAZË PERFORMANCE
E FITUAR PËR VITIN 2025 DHE SHTIM BUXHETI PËR VITIN 2026

KËSHILLIT TË BASHKISË PATOS

Në mbështetje të ligjit nr. 139, datë 17.12.2015 “Për Vetëqeverisjen Vendore”, i ndryshuar, nenit 4 dhe 24 të ligjit nr. 9936, datë 26.06.2008 “Për Menaxhimin e Sistemit Buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, ligjit nr. 10 296, datë 08.07.2010 “Për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin”, kreut VII-të të ligjit nr. 68, datë 27.04.2017 “Për Financat e Vetëqeverisjes Vendore”, VKB nr. 82, datë 17/12/2025 “Mbi miratimin e numrit të përgjithshëm të punonjësve dhe buxhetin e bashkisë Patos për vitin 2026”.

KËRKOJMË:

1. Të miratojë shtesë buxheti për vitin 2026 nga fondi “Granti me bazë performance” në vlerën 8,843,866.21 lekë, i ndarë si më poshtë:
 - **3,955,056.18** (tre milion e nëntëqind e pesëdhjetë e pesë mijë e pesëdhjetë e gjashtë pikë tetëmbëdhjetë) lekë, Granti i brendshëm;
 - **4,888,810.03** (katër milion e tetëqind e tetëdhjetë e tetë mijë e tetëqind e dhjetë pikë zero tre) lekë, Granti i huaj;
2. Të miratojë përdorimin e grantit me bazë performance për:
 - a. Shtesë fondi në projektin “Krijimi i parkut rekreativ në lagjen e Re (ku përfshihet ndërtimi i fushave të basketbollit)”, miratuar në vitin 2026 në vlerën **5,162,031** (pesë milion e njëqind e gjashtëdhjetë e dy mijë e tridhjetë e një) lek;
 - b. Shtesë fondi në zërin buxhetor “*Studim, projektim dhe hartim i PDV-ve*”, në vlerën **3,681,835** (tre milion e gjashtëqind e tetëdhjetë e një mijë e tetëqind e tridhjetë e pesë) lekë .

Struktura buxhetore për këtë shtesë fondi është:

- Shtesë Grupi 00, kapitulli 1, programi AD112, kod projekti 1120191, me vlerë **5,162,031** lekë.
- Shtesë Grupi 00, kapitulli **2**, programi AD112, kod projekti 1120114, me vlerë **3,681,835** lekë.

Drejtuesi i Programit

Punëve Publike

Boreta Murati

Dr. Finance

Mimoza Shtëmbari

Koordinator i GMS-së

Ina Sauli

Juriste
Joana Sherfi



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

BASHKIA PATOS
DREJTORIA E ZHVILLIMIT TË TERRITORIT DHE EMERGJENCAVE CIVILE

Nr. 213 / Prot.

Patos, më 19 / 01 / 2026

RELACION
MBI PËRDORIMIN E GRANTIT ME BAZË PERFORMANCE E FITUAR PËR
VITIN 2025 DHE SHTIM BUXHETI PËR VITIN 2026

KËSHILLIT TË BASHKISË PATOS

Në mbështetje të ligjit nr. 139, datë 17.12.2015 “Për Vetëqeverisjen Vendore”, i ndryshuar, nenit 4 dhe 24 të ligjit nr. 9936, datë 26.06.2008 “Për Menaxhimin e Sistemit Buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, ligjit nr. 10 296, datë 08.07.2010 “Për Menaxhmin Financiar dhe Kontrollin”, kreut VII-të të ligjit nr. 68, datë 27.04.2017 “Për Financat e Vetëqeverisjes Vendore”, VKB nr. 82, datë 17/12/2025 “Mbi miratimin e numrit të përgjithshëm të punonjësve dhe buxhetin e bashkisë Patos për vitin 2026”,

Në buxhetin për vitin 2025 është parashikuar objekti me emërtim “Ndërtimi i fushave të basketbollit në Njësitë Patos” në vlerën **10,574,029** (dhjetë milion e pesëqind e shtatëdhjetë e katër mijë e njëzet e nëntë) lekë, investim i cili nuk është realizuar në kohë për shkak të hartimit të projektit dhe si pasojë objekti nuk është prokuruar brenda vitit kalendarik 2025.

Projekti “Krijimi i parkut rekreativ në Lagjen e Re” ka parashikuar ndërhyrje në shtrirje më të gjerë duke përfshirë edhe ndërtimin e fushave të basketbollit dhe voleybollit (Zona A). Gjatë vitit 2026 prioritet për Bashkinë Patos është zbatimi i projektit me emërtimin ‘Krijimi i parkut rekreativ në Lagjen e Re’ dhe nga studimi i projektit ka rezultuar se vlera e nevojshme për realizimin e këtij investimi është **15,736,060** (pesëmbëdhjetë milion e shtatëqind e tridhjetë e gjashtë mijë e gjashtëdhjetë) lekë.

Pra në total granti i përfituar i performancës që i shtohet buxhetit për vitin 2026 është **8,843,866.21** (tetë milion e tetëqind e dyzet e tre mijë e tetëqind e gjashtëdhjetë e gjashtë pikë njëzet e një) lekë me tvsh, të ndarë si:

1. **3,955,056.18** (tre milion e nëntëqind e pesëdhjetë e pesë mijë e pesëdhjetë e gjashtë pikë tetëmbëdhjetë) lekë nga granti i brendshëm nga Pushteti qendror
2. **4,888,810.03** (katër milion e tetëqind e tetëdhjetë e tetë mijë e tetëqind e dhjetë pikë zero tre) lekë me tvsh nga granti i huaj.

Përdorimi:

- 1- Shtohet vlera prej **5,162,031** (pesë milion e njëqind e gjashtëdhjetë e dy mijë e tridhjetë e një) lekë në zërin buxhetor “Krijimi i parkut rekreativ në lagjen e Re (ku përfshihet ndërtimi i fushave të basketbollit)”.
- 2- Shtohet vlera prej **3,681,835** (tre milion e gjashtëqind e tetëdhjetë e një mijë e tetëqind e tridhjetë e pesë) lekë në zërin buxhetor “Studim, projektim dhe hartim i PDV-ve”.

I KËRKOJMË KËSHILLIT TË BASHKISË PATOS:

1. Të miratojë shtesë buxheti për vitin 2026 nga fondi “Granti me bazë performance” në vlerën 8,843,866.21 lekë, i ndarë si më poshtë:
 - **3,955,056.18** (tre milion e nëntëqind e pesëdhjetë e pesë mijë e pesëdhjetë e gjashtë pikë tetëmbëdhjetë) lekë, Granti i brendshëm;
 - **4,888,810.03** (katër milion e tetëqind e tetëdhjetë e tetë mijë e tetëqind e dhjetë pikë zero tre) lekë, Granti i huaj;
2. Të miratojë përdorimin e grantit me bazë performance për:
 - a. Shtesë fondi në projektin “Krijimi i parkut rekreativ në lagjen e Re (ku përfshihet ndërtimi i fushave të basketbollit)”, miratuar në vitin 2026 në vlerën **5,162,031** (pesë milion e njëqind e gjashtëdhjetë e dy mijë e tridhjetë e një) lek;
 - b. Shtesë fondi në zërin buxhetor “*Studim, projektim dhe hartim i PDV-ve*”, në vlerën **3,681,835** (tre milion e gjashtëqind e tetëdhjetë e një mijë e tetëqind e tridhjetë e pesë) lekë .

Për ndjekjen dhe zbatimin ngarkohet Drejtoria e Financës, Drejtoria e Zhvillimit të Territorit dhe Emergjencave Civile dhe Njësia e Prokurimit.

GRUPI I MENAXHIMIT

Drejtues Programi

Boreta Murati



Antarët e Grupit të Menaxhimit

Sokol Meta



Mario Tupa



Marsilda Lizaj



Ermenita Mici



ZV/KRYETAR

Ina Sauli

